



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD  
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



# Buxheti 2008

## Vizioni ynë

*“Ofrues të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta që japin shërbime të kualitetit të mirë, të qëndrueshme dhe efikase për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”*

## Misioni ynë

*“Të rregullojë sektorët e ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mënyrë transparente dhe të barabartë në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta japin shërbime kualitative, të qëndrueshme, të besueshme dhe me çmime të volitshme nëpër tërë Kosovën, duke u përkujdesur për mjedisin dhe shëndetin e publikut.”*

# Përmbajtja

Parathënie .....	2
1. Pjesa e Përgjithshme.....	3
2. Synimet Operative të ZRRUM-it .....	6
3. Të Hyrat e ZRRUM-it në 2008.....	8
4. Shpenzimet e ZRRUM-it në 2008.....	11

## Parathënie

---

Ky dokument jep një përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara të Zyrës Rregullore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) për vitin 2008 dhe shqyrton mundësinë për financimin e këtyre aktiviteteve. Dokumenti presupozon se ZRRUM do të jetë në gjendje që në tërësi ti financojë aktivitetet a planifikuara nga taksat vjetore të licencimit që paguhen nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave. Kjo formë e financimit të ZRRUM-it është në pajtim me Rregulloren 2004/49 e cila e ka themeluar ZRRUM-in dhe ka krijuar kuadrin ligjor për punën e ZRRUM-it, dhe poashtu është në përputhje me principet e pavarësisë rregullore dhe praktikën e mira për financimin e rregullatorëve ekonomik.

Pjesë përbërëse e këtij dokumenti janë edhe Shpenzimet e parapara për financimin e aktiviteteve të planifikuara të ZRRUM-it në 2008. Shpenzimet janë ndarë në grupe standarde: Personeli, Mallëra dhe Shërbime, dhe Shpenzime Kapitale. Rrjedhimisht, ky dokument përmban kapitujt vijues:

- Synimet Operative
- Të Hyrat
- Shpenzimet
  - Personeli
  - Mallëra dhe Shërbime
  - Shpenzimet Kapitale
- Konkluzion

## 1. Pjesa e Përgjithshme

### 1.1. Themelimi dhe Përgjegjësitë Ligjore të ZRRUM-it

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) është rregullator ekonomik i sektorëve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë që është themeluar më 26 Nëntor të vitit 2004 me Rregulloren 2004/49 në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

ZRRUM është përgjegjës për rregullimin e Ndërmarrjeve Publike dhe Ndërmarrjeve Shoqërore që ofrojnë shërbimet e ujësjetillës, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave. Përgjegjësitë kryesore të ZRRUM janë:

- Përcaktimi i tarifave që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve,
- Lëshimi i licencave për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave,
- Nxitja e konkurrencës në sektorët e ujit dhe mbeturinave përmes krahasimit të performancës ("benchmarking"),
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopolistike dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit,
- Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve,
- Themelimi dhe përkrahja e këshillave konsultative për konsumatorë,
- Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve nga e kaluara.

Pra ZRRUM është përgjegjës për të siguruar se Ndërmarrjet Publike (dhe ato Shoqërore) që ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave në Kosovë iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efikase dhe cilësore me çmim të arsyeshëm dhe korrekt.

Në përmbushjen e përgjegjësisë së veta rregullatore, ZRRUM udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Rregulloren 2004/49 dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorët e ujit dhe mbeturinave. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është dhënë me legjislacionin sekundar (në formën e 14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUM në Janar të vitit 2005.

ZRRUM aktualisht i përgjigjet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara. Pas dorëzimit të planifikuar të kompetencave të rezervuara nga PSSP te Kuvendi i Kosovës, ZRRUM pritet të jetë një organ i pavarur jo-ministral, i qeverisur nga një bord kolegjial i emëruar nga Kuvendi i Kosovës dhe poashtu përgjegjës ndaj tij.

### 1.2. Struktura Organizative e ZRRUM-it

Në përputhje me Rregulloren 2004/49 ZRRUM udhëhiqet nga Drejtori i cili është përgjegjës për funksionimin e Zyrës si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore.


Me qëllim të operimit më eficient, efektiv dhe me kohë, ZRRUM ka aprovuar strukturën organizative të organizimit sipas të cilës departamentet e ZRRUM-it i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUM-it.

ZRRUM përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore, Seksioni i Performancës, dhe Seksioni për Ligj dhe Licenca, ndërkaq përgjegjës për mbështetjen e biznesit të ZRRUM-it është Seksioni për Administratë dhe Financa.

Organizimi i brendshëm dhe procedurat administrative dhe rregullatore në bazë të së cilave funksionon ZRRUM-i janë përcaktuar me një dokument të veçantë të nxjerrë nga Drejtori i ZRRUM-it.

Struktura organizative e ZRRUM-it është dhënë në vijim:

#### STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM-IT NGA PRILL 2007



## Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore

Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore i ofron mbështetje të nevojshme Drejtorit të ZRRUM-it në përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të këtij Seksioni përfshijnë:

- (i) zhvillimin e metodologjisë dhe modeleve për llogaritjen tarifave të shërbimit,
- (ii) zhvillimin e praktikave dhe procedurave për aplikimin dhe shqyrtim të aplikacioneve për tarifa të shërbimit,
- (iii) udhëheqjen e procesit të përcaktimit të tarifave në frymën dispozitive ligjore në fuqi,
- (iv) shqyrtimin dhe evaluimin e të dhënave financiare nga raportet e kompanive të licencuara,
- (v) auditimin e të dhënave financiare të kompanive të licencuara, dhe
- (vi) mbështetjen në hartimin e legjislacionit sekondar të ZRRUM-it.

## Seksioni i Monitorimit të Performansës

Roli i Seksionit të Monitorimit të Performansës është që të organizojë sistemin e raportimit të kompanive të licencuara të ZRRUM-it dhe të përkujdeset për funksionimin e këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë ky Seksion ka përgjegjësi për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të raportuara dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore lidhur me performansën operative dhe financiare të ofruesve të licencuar të shërbimit.

Poashtu, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të Seksionit të Monitorimit të Performansës përfshihen edhe aspektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve (bashkëpunimi me dhe mbështetja e punës së Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, shqyrtimi i aplikacioneve lidhur me shkyçjet kolektive, vlerësimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit etj.).

## Seksioni i Çështjeve Ligjore dhe Licencimit

Seksioni i Çështjeve Ligjore dhe Licencimit i ofron mbështetje të nevojshme ligjore Drejtorit dhe stafit të ZRRUM-it në lidhje me aktivitetet e ZRRUM-it dhe përfaqëson Zyrën në të gjitha seancat administrative dhe gjyqësore para autoriteteve administrative, instancave të arbitrit, dhe gjykatave të Kosovës.

Ky Seksion poashtu është përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e praktikave dhe procedurave të licencimit si dhe udhëheqë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e licencimit të kompanive që janë nën mandatin rregullator të ZRRUM-it.

## Seksioni i Administratës dhe Financave të ZRRUM-it

Seksioni i Administratës dhe Financave është përgjegjës për funksionimin administrativ dhe financiar të ZRRUM-it. Ky Seksion i ofron mbështetje administrative, gjuhësore, të menaxhimit të të dhënave, dhe të mbikqyrjes së financave të brendshme për Drejtorin dhe stafin e ZRRUM-it.

Poashtu ky Seksion menaxhon prokurimin, procesin e buxhetimit, resurset njerëzore, dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me objektin administrativ dhe automjetet e ZRRUM-it.

## 2. Synimet Operative të ZRRUM-it

### 2.1. Synimet Operative

ZRRUM është i përkushtuar që në vitin 2008 të arrijëpërbushjen e synimeve operative si vijon:

**Synimi 1:** **Avansimi i procesit të përcaktimit të tarifave** për shërbimet e ujit dhe mbeturinave të ngurta që mundësojnë qëndrueshmëri afatgjatë financiare të ofruesve të shërbimeve

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmirren aktivitetet vijuese:

1. Përcaktimi kalendarit rregullator me përshkrimin e detajuar të afateve për aktivitetet konkrete si: informacionet e kërkuara, afatet e dorëzimit, proceset e konsultimit dhe procesi i aprovimit.
2. Zhvillimi dhe testimi i modelit të ndryshuar që nënkupton bashkëpunimin me ofruesit e shërbimeve për dorëzimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e testimit të modelit tarifor.
3. Shqyrtimi i detajuar i të dhënave të kompanive në aplikacionet e tyre tarifore dhe në planet e tyre të biznesit.
4. Zhvillimi i procesit të konsultimit me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për tarifën e propozuar.
5. Aprovimi i tarifave të reja sipas dhe publikimi i tyre.

**Synimi 2:** **Ngritja e efikasitetit përmes stimulimit të konkurrencës** në sektorin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave duke përdorur krahasime ("benchmarking") lidhur me performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave.

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmirren aktivitetet vijuese:

1. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të raportuara nga ana e ofruesve të shërbimeve për vitin 2007.
2. Vlerësimi i saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve përmes procesit të auditimit të tyre.
3. Rishikimi i sistemit të vlerësimit dhe rangimit të kompanive dhe zhvillimi i i mëtutjeshëm i këtij sistemi.
4. Përpilimi dhe publikimi i raportit vjetor të performancës së ofruesve të shërbimeve për vitin 2007.

**Synimi 3:** **Ngritja e nivelit të zbatimit të standardeve të shërbimit** nga ana e ofruesve të shërbimit të ujit dhe mbeturinave.

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmirren aktivitetet vijuese:

1. Informimi më i mirë i ofruesve të shërbimeve me obligimet e tyre që dalin nga kuadri rregullator dhe licencat e shërbimit përmes një manuali që do të hartohet dhe të iu shpërndahet atyre.

2. Hartimi i procedurave të detajuara për lirim të ofruesve të shërbimeve nga përmbushja e standardeve të përcaktuara të shërbimit si dhe për masat për mospërmbushjen e tyre.
3. Auditimi i nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimit.
4. Rishikimi i standardeve të shërbimit në konsultim me ofruesit e shërbimeve dhe Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve.

**Synimi 4:** **Përforcimi i pavarësisë rregullatore dhe pavarësisë financiare** të ZRRUM-it si rregullator ekonomik i sektorit të shërbimeve të ujit (jo edhe mbeturinave) me legjitimitet dhe pavarësi të plotë dhe të qartë, që iu përgjigjet institucioneve të Kosovës.

Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar të ndërmirren aktivitetet vijuese:

1. Angazhimi për aprovimin e draftit të Ligjit i cili e zëvendëson Rregulloren 2004/49 dhe përcakton më qartë pavarësinë rregullatore dhe financiare të ZRRUM-it si autoritet që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.
2. Hartimi i Planit të Biznesit për periudhë 5-vjeçare (2009 – 2013)
3. Faturimi dhe inkasimi i rregulltë i taksave të licencimit si burim për financimin e aktiviteteve të ZRRUM-it.
4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i politikave dhe procedurave të brendshme administrative.
5. Ngritja e kapaciteteve profesionale të ZRRUM-it përmes trajnimeve dhe vizitave studimore

**Synimi 5:** **Ngritja e transparencës dhe besimit në procesin rregullator** të palët e interesit

1. Publikimi dhe shpërndarja e qartë e të gjitha çështjeve dhe vendimeve rregullatore në gjuhët zyrtare në disa pika të qasjes së informatave (web-faqe, media elektronike dhe të shkruara, konferenca për shtyp etj.).
2. Zhvillimi i dhe avansimi i sistemit të relacioneve me publikun dhe planeve të komunikimit me publikun.
3. Krijimi i procedurave të procesit të konsultimit.
4. Avansimi i rolit dhe ngritja e profilit të Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve.
5. Inicimi i idesë për krijimin e Komitetit Këshillues që do të përbëhej nga palët kyçe të interesit (institucionet akademike, institucionet qeveritare, shoqëria civile, konsumatorët etj.) me qëllim të përfshirjes sa më të gjërë në procesin rregullator.
6. Zhvillimi i relacioneve të mira dhe bashkëpunimit me rregulatorët tjerë dhe institucionet tjera relevante të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë.

Arritjen e synimeve operacionale ZRRUM e bën përmes departamenteve përkatëse të ZRRUM-it në formën e aktiviteteve përkatëse siq janë paraqitur në Planin e Veprimit për 2008.

## 3. Të Hyrat e ZRRUM-it në 2008

### 3.1. Të Hyrat nga Taksat e Licencimit

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49, ZRRUM do ti financojë aktivitetet e veta të planifikuara për vitin 2008 nga të hyrat e realizuara përmes taksave të licencimit që paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave.

Në vitin 2008 ZRRUM planifikon të mbledhë taksat e licencimit prej 16 ofruesve të licencuar që ofrojnë shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza, grumbullimit të mbeturinave dhe të deponimit të mbeturinave, si vijon:

- 7 ofrues regjional të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza;
- 1 ofrues i shërbimeve të ujit me shumicë;
- 7 ofrues regjional të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave; dhe
- 1 ofrues i shërbimeve që menaxhon deponitë.

Vlera totale e faturimit për taksa të licencimit duhet të korrespondojë me shpenzimet e buxhetuara të ZRRUM-it për vitin 2008, të përlogaritura në vlerë 301,330 EUR. Kjo vlerë do të faturohet te 16 kompanitë e licencuara si përqindje në qarkullimin vjetor bruto të këtyre kompanive.

Lartësia e taksës vjetore të licencimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave është përlogaritur në bazë të qarkullimit vjetor në vitin 2007. Duhet të sqarohet këtu se vlera e qarkullimit bruto të kompanive për vitin 2007 është llogaritur si shumë e të dhënave të raportuara për periudhën Janar-Qershor 2007 dhe të dhënave të vlerësuara për periudhën Korrik - Dhjetor 2007.

Bazuar në këto përlogaritje lartësia e taksës vjetore të licencimit për vitin 2008 që ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave duhet ti paguajnë ZRRUM-it është **0.93%** të qarkullimit të tyre vjetor bruto.

Tabela 3.1 jep pasqyrën e qarkullimit vjetor të ofruesve të shërbimeve që paraqet bazën për llogaritjen e vlerës së taksës vjetore të licencimit që do tu faturohet atyre nga ZRRUM-i.

### 3.2. Donacionet

Gjatë vitit 2008 ZRRUM do të përfitojë nga projekti i financuar nga Agjencia Europiane për Rindërtim (AER), projekt ky i filluar në Shtator të vitit 2006 dhe planifikuar të përfundojë në Maj 2008. Projekti konsiston në ofrimin e mbështetjes institucionale të ZRRUM-it nga kompania konsulente IPA dhe në ngritjen e kapaciteteve përmes ekspertëve nga fusha e tarifave, menaxhimi i mbeturinave etj. Vlera totale e projektit është 800,000 EUR.

Në kontekst të përfitimeve nga mbështetja e donatorëve, duhet të përmendet edhe fakti se ZRRUM ka arritur marrëveshje me Zyrën Zvicërene për Zhvillim (SDC) për mbështetjen e ZRRUM-it me një projekt 2-vjeçar duke filluar nga 1 Janari i vitit 2008. Ky projekt konsiston në financimin e një eksperti lokal që do të mbështesë ZRRUM-in lidhur me monitorimin e performansës së ofruesve të shërbimeve.

Poashtu, ZRRUM ka aplikuar dhe shpreson të përfitojë në pjesën e parë të vitit 2008 nga mbështetja e projektit të UNDP/CBEI në kuptimin që kjo e dyta të financojë një ekspert tarifor afat shkurtë (2/3muaj) në mbështetjen e ZRRUM-it në procesin tarifor gjatë pjesës së parë të vitit 2008.

Tabela 3.1: Qarkullimi bruto vjetor I ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në vitin 2007

SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË			SHËRBIMETE E MBETURINAVE		
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)	Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "PRISHTINA"	Prishtina	9,395,656.00	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "AMBIENTI"	Pejë	941,758.00
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	849,407.00	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "EKO-REGJIONI"	Prizren	1,709,482.00]
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "RADONIQI"	Gjakovë	2,430,873.00	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "PASTERTIA"	Ferizaj	1,050,806.00
Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtinë	276,949.00	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "UNITETI"	Mitrovicë	1,172,785.00
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "UJESJELLSI REGJIONAL"	Mitrovicë	2,633,592.00	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "CABRATI"	Gjakovë	658,049.00
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDRODRINI"	Pejë	2,678,142.00	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "HIGJIENA"	Gjilan	1,133,909.00
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROREGJIONI"	Prizren	2,200,781.00	Kompania Regjionale e Grumbullimit të Mbeturinave "PASTRIMI"	Prishtinë	3,461,372.00
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "HIDROMORAVA"	Gjilan	1,297,990.00	Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë (KLMC/KMDK)	Prishtina	679,000.00
Totali – Ofruesit e Ujit dhe Ujërave të Zeza		21,763,390.00	Totali – Ofruesit e Shërbimeve të Mbeturinave:		10,807,161.00
TOTALI:		32,570,551.00			

Tabela 3.2: Lartësia e Taksës së Licencimit që ofruesit e licencuar të shërbimit duhet ti paguajnë ZRRUM-it në vitin 2008

LARTËSIA E TAKSËS SË LICENCIMIT PËR OFRUESIT E LICENCUAR TË SHËRBIMEVE NË VITIN 2008					
KRU SH.A. "PRISHTINA", Prishtinë	Qarkullimi Vjetor Bruto	9,395,656	KRM "PASTRIMI", Pristina	Qarkullimi Vjetor Bruto	3,461,372
	%	28.85		%	10.63
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>86,925</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>32,023</b>
KRU SH.A. "HIDROREGJIONI", Prizren	Qarkullimi Vjetor Bruto	2,200,781	KRM "EKOREGJIONI", Prizren	Qarkullimi Vjetor Bruto	1,709,482
	%	6.76		%	5.25%
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>20,361</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>15,815</b>
KRU SH.A. "HIDRODRINI", Pejë	Qarkullimi Vjetor Bruto	2,678,142	KRM "AMBIENTI", Peja	Qarkullimi Vjetor Bruto	941,758
	%	8.22		%	2.89%
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>24,777</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>8,713</b>
KRU SH.A. "HIDROMORAVA", Gjilan	Qarkullimi Vjetor Bruto	1,297,990	KRM "HIGJIENA", Gjilan	Qarkullimi Vjetor Bruto	1,133,909
	%	3.99		%	3.48%
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>12,008</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>10,490</b>
KRU SH.A. "BIFURKACIONI", Ferizaj	Qarkullimi Vjetor Bruto	849,407	KRM "PASTERTIA", Ferizaj	Qarkullimi Vjetor Bruto	1,050,806
	%	2.61		%	3.23%
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>7,858</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>9,722</b>
KRU SH.A. "UJËSJELLSI REGJIONAL", Mitrovicë	Qarkullimi Vjetor Bruto	2,633,592	KRM "UNITETI", Mitrovica	Qarkullimi Vjetor Bruto	1,172,785
	%	8.09		%	3.60%
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>24,365</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>10,850</b>
KRU SH.A. RADONIQI", Gjakovë	Qarkullimi Vjetor Bruto	2,430,873	KRM "CABRATI", Gjakova	Qarkullimi Vjetor Bruto	658,049
	%	7.46		%	2.02%
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>22,489</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>6,088</b>
Hidrosistemi " IBER- LEPENCI", Prishtinë	Qarkullimi Vjetor Bruto	276,949	SH.A. KLMC/KMDK, Prishtinë	Qarkullimi Vjetor Bruto	679,000
	%	0.85		%	2.08%
	<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>2,562</b>		<b>Taksa Vjetore e Licencimit (EUR)</b>	<b>6,282</b>

## **4. Shpenzimet e ZRRUM-it në 2008**

### **4.1. Shpenzimet e Personelit**

Personeli i ZRRUM-it në vitin 2008 do të konsistojë në 19 të punësuar, që të gjithë staf vendor. Lartësia e pagave për stafin është dhënë në tabelën 2, dhe këto paga janë përcaktuar ashtu që të njëjtat të jenë në nivel që është i krahasueshëm me nivelin e pagave që marrin të punësuarit në sektorin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë. Kjo është sipas ZRRUM-it e domosdoshme për të qenë në gjendje për të motivuar stafin me paga konkurruese me sektorin e shërbimeve që është objekt i rregullativës së ZRRUM-it dhe për të ruajtur nga largimi ekspertizën e krijuar gjatë viteve të kaluara.

**Tabela 4.1: Skema e Pagave të Personelit të ZRRUM-it**

SKEMA E PAGAVE TË ZRRUM-it								
No.	Titulli - Pozita	Përgatitja Profesionale			Gjuhët			Kat. e Pagës
		Arsimimi Post-Diplomik	Diploma e Universitet.	Shkollae mesme	Shqip	Serb.	Ang.	
1	<b>Drejtori i ZRRUM-it</b>		x		x	x	x	VII
2	Asistenti Personal			x	x	x	x	III
3	<b>Udhëheqës i Administratës dhe Financave</b>		x		x	x	x	VI
4	Zyrtar i Administratës dhe Burimeve Njerëzore		x		x	x	x	IV
5	Zyrtar i Buxhetit dhe Financave		x		x	x		IV
6	Zyrtar i Prokurimit		x		x	x		IV
7	Zyrtar I Shërbimeve IT		x		x	x	x	IV
8	Përkthyes profesional (shqip/serbisht/anglisht)		x		x	x	x	IV
9	Pastrues dhe Mirëmbajtës			x	x			I
10	<b>Udhëheqës i Tarifave dhe Financave Rregullatore</b>		x		x	x	x	VI
11	Analist I Tarifave dhe Financave - Mbeturina		x		x	x		V
12	Analist i Tarifave dhe Financave - Ujë & Ujëra të Zeza		x		x	x		V
13	<b>Udhëheqës I Seksionit të Performansës</b>		x		x	x	x	VI
14	Analit i Relacioneve Kompani - Konsumator		x		x	x		V
15	Analist i Monitorimit të Performansës - Ujë		x		x	x		V
16	Analist I Monitorimit të Performansës - Mbeturina		x		x	x		V
17	Inspektor për Ujë dhe Mbeturina		x		x	x		IV
18	<b>Udhëheqës i Seksionit Ligjor dhe të Licencave</b>		x		x	x	x	IV
19	Zyrtar I Licencimit			x	x	x		III

## 4.2. Mallëra dhe Shërbime

Shpenzimet e parapara të ZRRUM për kategorinë Mallëra dhe Shërbime si dhe Shpenzimet për Shërbimet Publike janë dhënë në tabelat vijuese (Tabela 4.3 dhe Tabela 4.4), në vijim:

**Tabela 4.3: Shpenzimet për Mallëra dhe Shërbime**

SHPENZIMET PËR MALLËRA DHE SHËRBIME		
Lloji i Shpenzimit	Vlera (EUR)	Vërejtje:
Shpenzimet e Udhëtimit	10,000	1 x 6 ditë + 5 x 3 ditë
Karburante për vetura	6,500	5 vetura
Karburante për gjenerator	1,500	1 gjenerator
Karburante për nxemje	4,500	
Mirëmbajtja dhe riparimi i objektit	3,000	
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	6,000	5 vetura
Telekomunikacionet	6,000	Kartelat për tel. (25x20x12)
IT shërbimet (internet)	2,400	
Shërbimet kontraktuale	12,000	Shërbimet e sigurimit
Shërbimet edukative dhe të trajnimit	7,700	
Shërbimet tjera të kontraktuara	17,000	Shpalljet, RP, Publikimet
Inventar i Zyrës	4,800	
Teknologjia Informative	5,500	Blerja e 5 kompjuterave
Pajisje tjera	8,500	Blerja e një serveri
Qiraja për Zyrë	42,000	
Furnizimet për Zyrë	7,200	
Furnizimet tjera	1,000	
Shpenzimet tjera për Mallëra dhe Shërbime	3,000	
<i>Shpenzimet për Komisionet Konsultative të Konsumatorëve*(KKK)</i>	24,600	Shpenzimet e rrugës dhe të tjera të anëtarëve të 7 KKK-
<b>Gjithësejt Mallëra dhe Shërbime:</b>	<b>173,200</b>	

**Tabela 4.4: Shpenzimet për Shërbime Publike**

SHPENZIMET PËR SHËRBIMET KOMUNALE		
Shpenzimet e ujit	500	
Shpenzimet e enenergjisë elektrike	2,000	
Shpenzimet mbeturinave	350	
Shpenzimet e telefonisë fikse	1,800	
<b>Gjithësejt Shpenzimet e Shërbimeve Publike:</b>	<b>4,650</b>	

### 4.3. Shpenzimet Totale të ZRRUM për vitin 2008

Në tabelën vijuese (Tabela 4.5) është dhënë përmbledhja e shpenzimeve totale të ZRRUM-it të parashikuara për vitin 2008.

**Tabela 4.5: Shpenzimet totale të ZRRUM-it në vitin 2008**

SHPENZIMET TOTALE TË ZRRUM NË 2008	
1. Shpenzimet e Personelit	123,480.00
2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve	173,200.00
3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike	4,650.00
<b>Gjithësejt Shpenzimet e ZRRUM-it:</b>	<b>301,330.00</b>

### 4.4. Konkluzion

Të hyrat e ZRRUM-it nga taksat e licencimit për mbulimin e shpenzimeve rrjedhëse pritet të ndodhë në baza mujore për të korresponduar me shpenzimet e ZRRUM-it të cilat janë të njëtrajtshme përgjatë tërë vitit.

Në rast të problemeve në arkëtimin të taksës së licencimit nga kompanitë e licencuara, ZRRUM do të duhet të kërkojë alokime nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të mund me përmbushë përgjegjësitë e veta ligjore dhe për të ushtruar veprimtarinë e vet rregullatore.

Më 15 Dhjetor 2007

Drejtori i ZRRUM

Afrim Lajci